



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 287-2/ 2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Ferki Xhaferi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarës së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, nga kandidati për deputet Taulant Kryeziu, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 18.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar, kërkesa Anr. 287-2/2019 e datës 17.10.2019 për rishqyrtimin e Vendimit të PZAP-it, Anr.287/2019, të datës 06.10.2019, të paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një kërkesë për rishikim-apel më datë 17.10.2019, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se vendimin Anr.287/2019 i datës 06.10.2019, ka një mos përputhje në mes të dispozitivit dhe arsytimit të këtij vendimi, ku theksohet se në dispozitiv thuhet se Taulant Kryeziu kandidat për deputet nga radhët e LVV-së ka lejuar vazhdimin e sponsorizimit të fushatës zgjedhore në rrjetin social “Facebook”, ndërsa në arsytimin e këtij vendimi thuhet se LDK pretendon se kandidati nga radhët e LVV-së Taulant Kryeziu përmes instagramit ka bërë thirrje për të votuar. I njëjti në kërkesën e tij thekson se PZAP-i me datën 06 tetor 2019 ka nxjerr vendimin Anr 287/2019, ndërsa subjektin politik LVV e ka njoftuar me datën 17.10.2019, me çka sipas parashtrësimit të apelit vendimi në fjalë është dorëzuar pas afatit ligjor.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se:

Apeli-Kërkesa për rishqyrtim është e pabazuar.

Neni 118.4 i LKP-së parasheh; *Mund të apelohej vendimi i PZAP-it, sikurse që PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuara.*

Lidhur me pretendimet e parashtruesit te apelit se ne dispozitiv është potencuar shprehja Facebook ndërsa në arsyetim Instagram, Paneli vlerësoi se shkelja si e tillë veq ka ekzistuar nëpërmjet rrjeteve sociale si në instagram ashtu edhe në facebook. Ndërsa lidhur me pretendimin se vendimi në fjalë ju është dorëzuar jashtë afatit ligjor, paneli vlerëson se vendimi në fjale është marrë brenda afatit të përcaktuar me ligj, çka nënkupton se lidhur me këtë rast është vendosur brenda afatit të paraparë, ndërsa dorëzimi i tyre më tepër është i karakterit teknik se sa përmbajtjesor, me çka nënkupton se nga momenti i pranimin te vendimit në fjalë pala ankuese ka të drejtë në ankesë, e që në këtë rast nuk iu ka humbur e drejta që të paraqes kërkes për rishikim të vendimit siç edhe e ka vepruar në rastin konkret.

Prandaj PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e lartcekura vendosi që apelin- kërkesën për rishqyrtim të refuzoje si të pabazuar në kuptim të nenit 118 par.4 e lidhur me nenin 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 287-2/2019 më datën 18.10.2019



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.